



PROCESVERBAL II/2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së II (dytë) për vitin 2022 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 18.02.2022
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Kryetari i Komunës z. Bali Muharremaj
Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësuesi i OSBE-së
Përfaqësuesi i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjeksisë Familjare në Suharekë;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës të punëtorëve të Administratës së Komunës;
4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të realizuara në vitin 2020 dhe vitin 2021 për shfrytëzim në vitin 2022;
5. Shqyrtim i projekt-vendimt për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për bursa;
6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për pronë;
7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale,”Eko-Regjioni”Sh.A;
8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zgjedhjen e Drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave;
9. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-61754;
10. Njoftimi i planit të prokurimit për vitin 2022;
11. Raporti i punës për zyrën e prokurimit për vitin 2021;

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit. I njofton me rendin e ditës dhe thotë se ka një pikë shtesë në rend dite,e cila ka të bëjë me formimin e komisionit për ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste në mes të ndërtuesve Bashkim Sali Hoxha dhe Sami Dërvish Elshani.Kryesuesi hap debatin.

Urim Suka - përshëndet të pranishmit. Nuk i kam informatat për këtë pikë dhe nuk di pse është aq e ngutshme. Kërkoj që ta futni në rend dite pikën pyetje dhe përgjigje.

Kryesuesi - në seancën e radhës të Asamblesë do të jetë edhe kjo pikë.

Dardan Berisha - përshëndet të pranishmit. Kam qenë pjesë e komisionit dhe pothuaj dokumenti është i gatshëm,vetëm Bashkimi nuk është pajtu dhe është ndal procesi. Drafti është i gatshëm dhe vetëm do të vazhdohet.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shtesë për në rend dite.

5 për, 1 abstenim -Miratohet

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - a keni vërejtje në procesverbal?

Liridon Fandaj - përshëndet të pranishmit. Te të pranishmit është cekë që ka qenë Kryetari, mirëpo Kryetari nuk ka qenë prezent.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjeksisë Familjare në Suharekë;

Kryesuesi - kjo ka qenë kërkesë e Qendrës për Mjeksi Familjare. Pjesë e këtij projekt-statuti ka qenë edhe zyrtari ligjor dhe ai kryesisht do ta elaboroj më gjerësisht.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor dhe si kryesues i këtij komisioni jep sqarime rreth hartimit të statutit të Qendrës Kryesore për Mjekësi Familjare.

Urim Suka - nuk kemi diçka specifike. Ekspertët tanë janë duke e trajtue statutin dhe çështjet që janë në interes me i thënë. Ne do ti themi në Asamble dhe për ne kalon për Asamble.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës të punëtorëve të Administratës së Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Avni Bytyqi - paraprakisht ata që kanë qenë anëtar të Asamblesë e din që ka kalu në vendim, por ministria e ka kthye sepse Komuna nuk e ka pas të planifikuar në buxhet për vitin 2022. Ne nuk patëm mundësi ta rishqyrtojmë në Kuvend dhe ta miratojmë prap si kërkesë, për arsye se nuk ishte miratu buxheti me kohë. Tash buxheti është i miratuar dhe në kuadër të buxhetit është e planifikuar çështja e pagesës së shujtës së punëtorëve.

Urim Suka - e mbështesim kërkesën, por dua më shumë sqarime. Në çfarë forme do të shkojnë këto mjete?

Avni Bytyqi - ideja është me u miratuar në Asamble dhe me përcaktuar vlerën financiare për shujtën, ndërsa se si do të implementohet, mbetet të shihet nga ekspertët një formë sa më e mirë e mundshme në zbatim të ligjit.

Fadil Hoxha - përshëndet të pranishmit. Problemi i implementimit të pagesës është kogja i vështirë, sepse përmes listës së pagave nuk kemi të drejtë. Kemi mendu një formë dhe duhet të shkohet si pjesë e mallrave dhe shërbimeve dhe duhet për secilin punëtor me bo edhe një kërkesë. Me i bo regjistrimet në Thesar dhe me iu pagu në këtë formë, ose me shku përmes prokurimit, me gjet një operator ekonomikë.

Mirëpo unë nuk kisha preferua me shku me 3.5 euro,sepse edhe ashtu buxheti është i ngarkuar dhe është e vështirë të implementohet.

Dardan Berisha - sa është numri i përgjithshëm i punëtorëve të administratës?

Fadil Hoxha - nr. i punëtorëve është 194.

Dardan Berisha - a do të kompensohen vetëm në momentin kur të hyn në fuqi?

Fadil Hoxha - nga një janari janë të planifikuara deri më 31.12 2022.

Dardan Berisha - janë edhe mësimdhënësit dhe sektor tjerë që e kanë pothuaj të njëjtin problem.

Fadil Hoxha - arsimi vjet i ka marrë me përmbarues pjesën e shujtës,edhe pse Komuna nuk e ka obligim por ministria. Në këtë rast nëse merret një vendim,administrata është mirë me bo një zgjidhje,që as Komuna mos me pagu përmbarues por edhe ata mi kry shërbimet dhe me marrë pjesën që u takon.

Bulëza Kuçi - pse Komuna po pret që arsimi ta merr me përmbarues?

Fadil Hoxha - për arsim nuk e ka obligim Komuna,por Ministria e arsimit ,sepse ajo ka bo marrëveshje.

Dardan Berisha - ne duhet me arrit ni përfundim,që as mos me dëmtu Komunën dhe as mos me has në kundërshtim me punëtorët e administratës.

Sanie Kuçi - përshëndet të pranishmit. Unë i jam gëzu kësaj pike të rendit të ditës sepse është sektori që paguhet më pak në institucione publike. Marrë shembull drejtorinë e urbanizmit,ku punojnë 6 zyrtar të cilët kanë ngarkesa të mëdhaja të punës. Një stimulim i tillë, unë e shoh shumë të arsyeshme edhe me vlerën 3.5 euro.

Liridon Fandaj - zyrtari ligjor thotë që janë të planifikuara në buxhet ,dhe janë dikun 180 mijë euro që ndikojnë në buxhet. Ne duhet të dimë ku janë të planifikuara?

Fadil Hoxha - është një kod buxhetor që e specifikon ekskluzivish, që nuk janë dreka dhe darka por shujta. Në atë kod secila drejtori në bazë të numrit të punëtorëve,kemi shku dhe i kemi nda nga 2.5 euro.Kurse me shku me 3.5, unë tash nuk e kam të planifikime.

Kryesuesi - është e drejtë e sindikatës me bo kërkesën. Ju në bazë të buxhetit e keni parapa 2.5,por unë besoj që me 3 euro është e mjaftueshme përshkak që janë rrit edhe çmimet në treg.

Liridon Fandaj - unë nuk jam kundër shujtës,por janë edhe punëtorët shëndetësor që e kanë një koeficient pak më të ulët.

Kryesuesi - ata e marrin që nga viti 2002.

Urim Suka - ne kemi një kërkesë prej punëtorëve që e mbështesim dhe janë të planifikime 2.5 dhe në anën tjetër ka ardh një projekt-vendim i ekzekutivit ku shkruan 3.5 euro.

Unë kërkoj të di, se si këto mjete do ti bartni te punëtorët, në llogari apo me kontraktu një restorant?

Fadil Hoxha - janë dy forma. E para me shku me mallra shërbime por që është problem.

Kryesuesi - kërkesa e tyre është me 3.5 euro dhe ne kështu duhet ta përcjellim për Asamble,pastaj atje e diskutojmë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të realizuara në vitin 2020 dhe vitin 2021 për shfrytëzim në vitin 2022;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - a e ke pa Kryetar këtë vendim? 923 mijë euro i ke bartë. Normalisht ne e mbështesim.

Kryetari - dalloji të hyrat vetanake dhe grandet.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 5. Shqyrtim i projekt-vendimt për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për bursa;

Kryesuesi - elaboron këtë pikë dhe thotë se ky komision do të jetë prej 5 anëtarëve dhe të gjithë do të jenë nga Kuvendi. Hap debatin.

Kryesuesi - pasi sak debat e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për pronë;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe thotë se ky komision do të përbëhet prej pesë anëtarëve. Dy do të jenë nga Kuvendi, dy nga ekzekutivi dhe një nga sektori jo qeveritar. Hap debatin.

Urim Suka - duke u nis nga ajo që ka ndodh në Asamblenë e fundit në komisionet që keni formu, si keni mendu me i zgjedh anëtarët te komisioni i ankesave?

Kryesuesi - në Asamble do ti zgjedhim.

Dardan Berisha - te neni 5 i komisionit të ankesave është veç dy vite brenda mandatit të Kuvendit të Komunës, kërkoj sqarim.

Avni Bytyqi - secili komision që themelohet në Kuvend ka nga një ligj apo dispozitë ligjore. Ligji e parasheh që mandati i komisionit të pronës të jetë dy vjeçar.

Kryesuesi - ne hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, "Eko-Regjioni" Sh.A;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe thotë që komisioni përbëhet prej 3 anëtarëve. Dy nga Kuvendi dhe një e propozon Kryetari. Hap debatin.

Kryesuesi - pasi sak debat, e hedh në votim pikën 7.

Unanimisht Miratohet

Pika 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zgjedhjen e Drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave;

Kryesuesi - elaboron këtë pikë dhe thotë se ky komision do të jetë prej tre anëtarëve: Agim Rraqi - përfaqësues i DKA-së, Arta Hoti - përfaqësuese e prindërve dhe anëtari i tretë është nga Ministria e Arsimit. Hap debatin.

Bulëza Kuçi - Arta Hoti është profesoreshë, por përfaqësuese e prindërve nuk mundet me qenë sepse i ka fëmijët e vegjël. Si u përzgjedh?

Avni Bytyqi - këshilli i prindërve i tri shkollave e ka propozua si përfaqësuese Arta Hotin.

Urim Suka - nuk mundet përfaqësimi i tri shkollave me propozu .Është këshilli i prindërve i të gjitha shkollave të Komunës që e propozon,dhe nëse propozimi ka ardh nga ky këshill,ne e pranojmë.

Avni Bytyqi - prej këshillit të prindërve ka qenë anëtar Adem Derguti në KKSB,dhe ai e ka propozuar në bashkëpunim me anëtarët tjerë.

Bulëza Kuçi - a ka qenë edhe më herët Arta Hoti në komision?

Avni Bytyqi - po,ka qenë.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 9. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-61754;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Kryetari - ne kemi planifiku buxhet mi kry të gjitha obligimet deri 31 dhjetor të vitit të kaluar.

Liridon Fandaj - deri kur merren parasysh aplikacionet?

Avni Bytyqi - nëse shfuqizohet,shfuqizohet prej 1 janar 2022.

Kryesuesi - e hedh në votim.

5 për,2 kundër,Miratohet

Pika 10. Njoftimi i planit të prokurimit për vitin 2022;

Kryesuesi - e keni në material njoftimin e planit të prokurimit për vitin 2022.Besoj në Asamble zyrtari i zyrës së prokurimit na informon më në detale.

Pika 11. Raporti i punës për zyrën e prokurimit për vitin 2021;

Kryesuesi - edhe për këtë pikë e keni materialin dhe komplet raportin.Në Asamble do të na informojë më gjerësisht zyrtari i prokurimit.

Pika 12 - shtesë Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;

Kryesuei - e hedh në votim.

5 për ,2 apstenime, Miratohet

Takimi përfundoi: 13:45

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj